



Objektivat strategjike të Platformës CiviKos

2015-2017

Vizioni dhe misioni

Vizioni: Shoqëri ku promovohen vlerat e transparencës, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirës në zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror.

Misioni: Civikos është bashkim vullnetar i organizatave të shoqërisë civile, të përkushtuara për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike.

Motoja e cila do përdoret nga Civikosi është: *Qytetari aktive në shërbim të zhvillimit të gjithëmbarshtëm shoqëror.*

Objektivat Afatgjate të Platformës CiviKos

Aktivitetet e Platformës CiviKos do të përqendrohen në arritjen e 3 objektivave të mëposhtme:

Objektiv strategjik 1 – Fuqizimi i marrëdhënieve me anëtarët dhe jo-anëtarët dhe portfolio e zgjeruar e shërbimeve

Qasja pro-aktive ndaj marrëdhënieve me anëtarët ekzistues është e një natyre të posaçme sepse ajo shihet si aset kryesor i punës së CiviKos-it. Krijimi i shërbimeve adekuate për anëtarët ekzistues duhet të jetë shtytës për të rritur numrin e anëtarëve të rinj nga fusha të ndryshme të veprimtimit që do i shtonin kredibilitetin dhe relevancën e ekzistimit të kësaj Platforme. Kjo do jetë e mundur të bëhet nëpërmjet nismave dhe intervenimeve si më poshtë:

- Promovimi i Kodit etik dhe inkurajimi i vazhdueshëm i organizatave anëtare për të zbatuar ngritjen e standardeve të anëtarëve;
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemit të informimit komunikimit me anëtarë (one stop shop);
- Themelimi i grupeve të punës dhe facilitimi i punës së tyre;
- Facilitimi i kontakteve në mes organizatave anëtare;
- Avokimi për përmbushjen e planeve të punës (vjetore dhe të punës);
- Komunikim i vazhdueshëm me publikun (PR).

Objektiv strategjik 2 – Koordinim i shoqërisë civile për zbatimin e strategjisë

Platforma CiviKos – Rr. Bedri Pejani 7/A, Prishtinë
web: www.civikos.net
e-mail: info@civikos.net
tel: 038 224 904



Përkrahja e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, përmes përkrahjes për funksionalizim të Këshillit për zbatim dhe 4 grupeve punuese sipas objektivave strategjike (Strategjia Qeveritare), aplikimi i principeve të konsultimit dhe bashkëpunimit si dhe promovimi i procesit të dialogut.

Përveç përkrahjes në zbatimin e Strategjisë, CiviKos do të monitoroj, raportoj dhe facilitoj duke përkrahur grupet punuese në hije (shadow teams) dhe duke përkrahur çfarëdo nisme të re të iniciuar nga OSHC-të, si dhe duke u përkujdesur që zbatimi i strategjisë të mos ndaloj vetëm në nivelin qendror por të ketë shtrirje edhe në nivelin lokal, si dhe të përkrahë OSHC-të rajonale në nisma të ndryshme lokale.

- Lehtësim i përfaqësimit të shoqërisë civile në Këshillin për Zbatim të Strategjisë;
- Ndërtim i sistemit për monitorim dhe monitorim i vazhdueshëm i zbatimit të Strategjisë (nga Platforma Civikos);
- Raporte periodike për zbatimin e Strategjisë;
- Presion i vazhdueshëm për zbatimin e Strategjisë (përfshirë edhe reagimet publike);
- Promovimi publik i Strategjisë;
- Rishikimi i zbatimit të Strategjisë (lehtësim i koordinimit të shoqërisë civile);
- Avokim për programimin e fondeve për objektivat strategjike.

Objektiv strategjik 3: Zhvillimi i dialogut të strukturuar mes shoqërisë civile dhe autoriteteve tjera publike

Përveç proceseve të dialogut që dalin nga Strategjia, CiviKos do të përkrah dhe facilitoj aplikimin e parimeve të ngjashme të partneritetit në procese tjera të dialogut që nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me Strategjinë, sipas dokumentit të aprovuar të Rregullave të Punës së CiviKos-it.

- Promovimi i parimeve të bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve tjera publike (Kuvendi i Kosovës, agjencitë e pavarura, komunat);
- Përfshirja e CiviKos-it në bashkëpunimin në mes të shoqërisë civile dhe Kuvendit të Kosovës;
- Asistenca për nismat e organizatave anëtare për zhvillimin e bashkëpunimit me autoritetet lokale.

Aktivitetet e ndërlidhura drejt arritjes së objektivave strategjike të lartpërmendura:

Elementi njeri (Human element) është gjithmonë në fokus të objektivave të CiviKosit dhe ata janë burimi kyç i suksesit tonë, prandaj zhvillimi i kapaciteteve të stafit është esencial për CiviKosin që të funksionojë bashkë me zhvillimin dhe ndryshimet organizative dhe ndryshimeve të mëdha në kontekstin e jashtëm.

Fokusi i fuqizimit të kapaciteteve të stafit do të udhëhiqet drejt ngritjes organizative, duke rritur kapacitetet e të punësuarve nëpërmes trajnimeve apo mundësive tjera për zhvillim. Një element tjetër që duhet të analizohet është metodologjia e punës me fokus që duhet dhënë vlerësimit, respektivisht janë të

Platforma CiviKos – Rr. Bedri Pejani 7/A, Prishtinë

web: www.civikos.net

e-mail: info@civikos.net

tel: 038 224 904



nevojshme trajnime për të matur performancën si dhe krijimin e logjistikës adekuate. Definimi i sistemit dhe procedurave është element kyç për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit si dhe për eliminimin e problemeve aktuale siç janë mungesa e rregullave/procedurave të brendshme, si dhe vlerësimi i punëtorëve.

Platforma CiviKos duhet të fillojë të dokumentojë të arriturat e saj në mënyrë sa më profesionale në mënyrë që të rrisë aftësitë dhe mundësitë për tërheqje të fondeve. Kjo do të arrihet edhe me ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe vendosjen e sistemit efektiv për shkëmbimin e përvojave, monitorim dhe vlerësim.

Marrë në konsideratë teknologjinë e re e cila është në dispozicion për organizatat e shoqërisë civile Platforma CiviKos do të riorganizojë web-faqen ekzistuese dhe ofrimin e informatave online duke prezantuar Facebook, Twitter dhe element tjerë të mediave sociale.